

Moto – Ne mundemi. Unë mundem.




Vazhdon fushata trevjeçare 2016-2018 për shënimin e 4 shkurtit – Ditës Botërore të luftës kundër kancerit nën moton “**Ne mundemi. Unë mundem.**” duke hulumtuar se si secili nga ne – qoftë bashkërisht ose si individ – mund të japë kontributin e tij për të zvogëluar ngarkesën globale që shkakton kancerin.


Kanceri nuk ndikon njësoj tek çdo njeri dhe secili individ në mënyrën e vet gjen forcë për të ndërmarrë aktivitete të ndryshme për ta zvogëluar ndikimin që ka kanceri tek individ, familja dhe bashkësia.

Dita botërore e luftës kundër kancerit paraqet një mundësi për të reflektuar se çfarë mund të bëni, të angazhoheni dhe të veproni. Çfarë do që të vendosni të bëni “Ne mundemi. Unë mundem.” bën dallim në luftën kundër kancerit.


Mesazhe themelore




Nxisni veprim, veproni



Ndalojeni kancerin




Krijoni shkolla të shëndetshme



Krijoni vende pune të shëndetshme




Krijoni qytete të shëndetshme




Përkrahni të tjerët që të kthehen në punë



Pranojeni sfidën




Përmirësojeni qasjen në kujdes për të sëmurët nga kanceri



Bëni ndryshime në politikë



Ndërtoni fuqi punëtore cilësore



Investoni në kontrollimin e kancerit




Bashkoni forcat për të bërë ndryshim



Të zgjedh një stil të shëndetshëm të të jetuarit



Të kuptoj se zbulimi i hershëm i kancerit shpëton jetë



Të kërkoj mbështetje




Të kthehem në punë



Të marr kontrollin mbi sëmundjen



Të dua dhe të më duan



Të bëj që zëri im të dëgjohet

“Në Ditën botërore të luftës kundër kancerit ne kemi një mundësi që në mënyrë kolektive të analizojmë strategjitë për kontrollimin e kancerit që të mund të identifikojmë formulat fituese të cilat do mund ta përshpejtojnë përparimin. Qëllimi jonë i përbashkët është që sa më pak individë të preken nga kanceri, sa më shumë individë të shërohen me sukses dhe të sigurohet një cilësi më e mirë e jetesës për personat gjatë trajtimit dhe në vazhdim të jetës së tyre”.

Union for International Cancer Control (UICC)

Përktheu:

Sektori për promovim, analizë dhe mbikëqyrje të sëmundjeve jainfektive